

Produkti i Brendshëm Bruto në 2008 (të dhëna paraprake)

Qëndrueshmëri në rritjen ekonomike

Rritja e volumit të produktit të brendshëm bruto për vitin 2008, në vleresimet paraprake, ka arritur në 7.8 përqind (pas rritjes prej 6.0 përqind të vitit 2007). Nga llogaritjet e deritanishme të vitit 2008 krahasuar me vitin 2007 në termat e rritjes të volumit, rritjet më të larta u shënuan nga sektori i industrisë gjithsej në (9.4 përqind), sektori i shërbimeve (8.4 përqind), ndërsa bujqësia pas rritjes vetëm prej 2.6 përqind në vitin 2007, arriti në 7.7 përqind në 2008. Gjatë vitit 2008 sektori i ndërtimit pësoi një rënie të ritmeve të rritjes në 4.8 përqind, nga 10.1 përqind që ishte në vitin 2007.

Të ardhurat për frymë vetëm 5 vitet e fundit kanë arritur në nivelin mesatar prej 2.304 € (3.051 \$ USA). Sipas vlerësimeve të fundit, kjo vlerë në vitin 2008 është rreth 2.785 € (4.073\$ USA). Shërbimet, gjatë dekadës së fundit janë sektori që zënë peshën më të madhe në ekonominë shqiptare dhe përfaqësojnë 50-60 përqind të vlerës së shtuar (vlerësuar në çmimet bazë korrente dhe neto nga FISIM). Vetëm për vitin 2008, shërbimet llogariten të zënë rreth 57.6 përqind. Industria dhe ndërtimi sëbashku përfaqësojnë 23.9 përqind të ekonomisë shqiptare në vitin 2008, edhe pse peshat mesatare të tyre gjatë dekadës së fundit ishte më pak se 15 përqind. Bujqësia siguroi rreth 18.5 përqind të të ardhurave në vitin 2008.

